



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 140 NGA KOALICIONI PËR
REFORMA, INTERGIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA LIDHUR ME
ORGANIZIMIN E KONCERTEVE/SHFAQJEVE KULTURORE ARGËTUESE
PËRGJATË OSE NË LIDHJE ME TURBIMET ELEKTORALE NGA SUBJEKTI
ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”**

Sot më datë __ Maj 2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen që i përket:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

OBJEKTI: Organizimi i koncerteve/shfaqjeve kulturore argëtuese përgjatë osë në lidhje me tubimet elektorale nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, 78, pika 9, dhe 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 142 nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara lidhur me organizimin e koncerteve/shfaqjeve kulturore argëtuese përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore

K O N S T A T O J:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 142 ID, regjistruar në datë 29.4.2025 me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara.

Denoncuesi pretendon se “në datë 11 prill 2025 në Tiranë, subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore, zhvilloi një tubim elektorale për hapjen e fushatës zgjedhore për zgjedhjet Parlamentare të datës 11 maj 2025. Në këtë takim elektorale kanë marrë pjesë edhe këngëtar të cilët kanë kënduar këngë përgjatë eventit. Në pamjet foto dhe video të postimeve të paraqitura evidentohet qartë thirrja, organizimi i veprimtarisë si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të subjektit zgjedhor”.

Pala kërkuese kërkon marrjen në shqyrtim të denoncimit si dhe sanksionimin e subjektit zgjedhor.

Në vijim të procedurave të hetim administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet email-it ju drejtua përfaqësuesit të subjektit zgjedhor për sqarime lidhur me pretendimet e denoncuesit duke i lënë një afat deri në datë 1.5.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, 78, pika 9, dhe neni 172 pika 1, të Kodit Zgjedhor,

V E N D O S:

1. T’i propozoj Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative ndaj subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, në vlerën **100 000 deri në 500 000 lekë**.
2. Rezultati i këtij vendimi i njoftohet subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

